

VENDIM
Nr. 52, datë 25.1.2017

PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE DHE TË PROCEDURAVE PËR NDËRTIMIN E LINJAVE DIREKTE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 33, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kushteve dhe të procedurave për ndërtimin e linjave direkte, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

KUSHTET DHE PROCEDURAT
PËR NDËRTIMIN E LINJAVE DIREKTE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Këto rregulla përcaktojnë kushtet dhe procedurat për ndërtimin e linjave të reja direkte në sektorin e energjisë elektrike.
2. Çdo subjekt i regjistruar si person juridik, sipas legjislacionit në fuqi, mund të aplikojë për ndërtimin e një linje direkte, duke u bazuar në parimet e mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë dhe të transparencës.
3. Linja direkte duhet të jetë në pronësi dhe/ose operohet nga një person juridik, i cili është i ndarë ligjërisht nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose Operatori i Sistemit të Transmetimit.
4. Të gjitha shpenzimet e bëra për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe operimin e një linje direkte duhet të përballohen nga personi juridik.
5. Për operimin e një linje direkte nuk ka nevojë për ndonjë licencë të lëshuar nga ERE.
6. Mundësia e furnizimit me energji elektrike nëpërmjet një linje direkte nuk pengon të drejtën e klientit për të lidhur marrëveshje furnizimi me energji elektrike nga një furnizues tjetër i zgjedhur prej tij.
7. Termat e përdorura në këto kushte dhe procedura do të kenë të njëjtin kuptim me përkufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

II. KRITERET DHE PROCEDURAT PËR NDËRTIMIN E LINJAVE DIREKTE PËR FURNIZIMIN ME ENERGJI BRENDA TERRITORIT TË SHQIPËRISË

1. Linjat direkte të cilat ndërtohen për lidhjen e një prodhuesi brenda vendit me një konsumator brenda vendit apo një shoqëri furnizimi që furnizon mjediset e veta apo klientët e vet të kualifikuar, miratohen nga ministri përgjegjës për energjinë, në vazhdim ministri, pas marrjes së mendimit të ERE-s.
2. Kërkesa për ndërtimin e një linje direkte shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:
 - a) Një ekstrakt historik të shoqërisë nga regjistri tregtar;
 - b) Struktura organizative e shoqërisë, lidhur me organizimin e brendshëm të saj;
 - c) Një përshkrim të kapaciteteve teknike, organizative dhe profesionale të shoqërisë;
 - ç) Informacion në lidhje me çdo përvojë të mëparshme në sektorin e energjisë, që provohet me dorëzimin e kopjeve të kontratave të nënshkruara apo të vërtetimeve përkatëse;
 - d) Vërtetim për pagimin e tatimeve, taksave, të sigurimeve shoqërore, të certifikuara nga organet tatimore dhe që shoqëria nuk është në ndonjë proces falimentimi apo likuidimi;
 - dh) Pasqyrat financiare të audituara për tri vitet e fundit dhe të certifikuara nga organet tatimore, kur kompania është e themeluar më shumë se tre vite më parë ose për periudhën e ekzistencës së kompanisë, kur ka më pak se tre vjet, si dhe çdo dokumentacion tjetër financiar, korrigjim që vërteton mundësinë

financiare për të kryer projektin e propozuar.

3. Shoqëria duhet të paraqesë dokumentacionin, si më poshtë:

- a) Projektin teknik të linjës direkte;
- b) Studimin e fizibilitetit për ndërtimin e linjës së drejtpërdrejtë;

c) Studimin ekonomik dhe financiar të linjës, duke marrë parasysh rreziqet e mundshme të investimit dhe mundësitë për mbulimin e shpenzimeve të investimit;

ç) Karakteristikat kryesore të linjës, duke përfshirë edhe rrugën e linjës nga prodhuesi te konsumatori, duke përfshirë çdo kryqëzim të mundshëm me rrjetin kombëtar të transmetimit dhe/ose rrjetin e shpërndarjes;

d) Kapacitetin neto të transmetimit të linjës direkte;

dh) Datën e pritshme për fillimin e punimeve të ndërtimit dhe datën e pritshme për përfundimin e linjës së drejtpërdrejtë;

e) Çdo miratim mjedisor të nevojshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

ë) Dokumentacionin përkatës ligjor që vërteton marrëdhënien afatgjatë me tokën, në sipërfaqen ku kalon linja direkte;

f) Deklaratën që gjatë gjithë periudhës së ndërtimit dhe të funksionimit të linjës direkte do të respektojë parashikimet e kodit të transmetimit dhe të shpërndarjes të aplikueshme në Republikën e Shqipërisë, si dhe çdo rregull tjetër teknik të OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. për të garantuar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e funksionimit të Sistemit Elektroenergjetik Kombëtar.

4. Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, ministria do t'i japë aplikuesit 60 (gjashtëdhjetë) ditë kohë shtesë për sigurimin e dokumentacionit të munguar. Kërkesa do të konsiderohet e refuzuar në rast se dokumentacioni i munguar nuk plotësohet brenda këtij afati.

5. Kur kërkesa pranohet, Ministria do të publikojë për 3 (tri) ditë me radhë në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 78/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare", një njoftim të shkurtër me këtë përmbajtje:

a) Një prezantim të shkurtër të kërkesës;

b) Një prezantim të shkurtër të aplikimit;

c) Adresën postare të ministrisë, ku çdo palë e interesuar mund të paraqesë kundërshtime ose komente mbi aplikimin;

ç) Afatin e fundit për paraqitjen e kundërshtimeve ose komenteve.

6. Ministria do të sigurojë që aplikimi dhe të gjitha dokumentet përkatëse të vendosen në dispozicion të publikut për konsultim publik, përveç rasteve kur, me kërkesë të aplikuesit, vendoset që disa dokumente ose informacione të mbahen konfidenciale.

7. Ministri miraton me urdhër ngritjen e një komisioni vlerësues të përbërë nga ekspertë me ekspertizën e nevojshme teknike, ekonomike dhe ligjore, punonjës të ministrisë ose të institucioneve të varësisë së Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Në çdo rast anëtarët e komisionit nuk marrin shpërblim shtesë për detyrën e kryer si anëtarë të komisionit.

8. Komisioni do të shqyrtojë dhe do të vlerësojë kërkesën brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e tij në ministri. Data e fillimit të shqyrtimit dhe e vlerësimit të kërkesës do të jetë data kur aplikimi konsiderohet i plotësuar.

9. Komisioni shqyrton dosjen e aplikimit dhe vendos rast pas rast nëse kriteret mëposhtme janë plotësuar:

a) Shoqëria dëshmon se ka aftësitë e nevojshme teknike, ekonomike dhe financiare për të ndërtuar dhe operuar linjën;

b) Funksionimi i linjës direkte, nuk ndikon në rrjetin kombëtar të transmetimit dhe/ose shpërndarjes;

- c) Funksionimi i linjës mund të rritë konkurrencën në tregun e energjisë.
- 10. Miratimi i një linje direkte përmban, të paktën, elementët e mëposhtëm:
 - a) Emrin e aplikantit;
 - b) Vendndodhjen e linjës direkte;
 - c) Datën e pritshme për përfundimin e projektit të zbatimit;
 - ç) Të drejtën e institucioneve për monitorimin e ndërtimit të linjës së drejtpërdrejtë;
 - d) Detyrimet e aplikuesit për të informuar periodikisht (çdo 3 muaj) ministrinë për ecurinë e projektit;
 - dh) Çdo kufizim në mbrojtjen e mjedisit;
 - e) Detyrimin për të nënshkruar një kontratë mes ministrisë dhe shoqërisë aplikuese. Kjo kontratë do të rregullojë çështje të tilla si, detyrimi për të njoftuar në mënyrë periodike ministrinë për ecurinë e projektit, procesin e marrjes së licencave dhe të lejeve të nevojshme për ndërtimin/funksionimin e linjës, mundësinë e ministrisë për të asistuar aplikuesin në çdo mënyrë të mundshme lidhur me aplikimin për marrje të autorizimeve /lejeve /licencave të nevojshme, mundësinë për të bërë ndryshime në projekt, zgjerimet dhe çdo çështje tjetër në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e palëve.
- 11. Ministri, përpara se të vendosë për miratimin sipas këtyre kushteve, duhet të marrë mendimin paraprak të ERE-s. ERE do të japë mendimin e saj brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve.
- 12. Në rast të refuzimit të aplikimit, ministria njofton aplikuesin për arsyet e një refuzimi të tillë. Aplikuesi mund të ankohet kundër vendimit të ministrisë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 13. Miratimi i ndërtimit të një linje direkte mund të transferohet pjesërisht ose plotësisht te një person i tretë juridik, vetëm me miratimin paraprak të ministrit. Transferimi nuk do të pengojë cilësinë dhe përmbushjen e afateve të projektit. Në çdo rast, në dokumentacionin e paraqitur nga personi juridik tek i cili transferohet kjo e drejtë duhet të garantohet se do të zbatohen parametrat teknikë të projektit dhe do të respektohet afati i realizimit të projektit, normat mjedisore dhe detyrimet e tjera të parashikuara në këtë vendim dhe në legjislacionin në fuqi.
- 14. Ministri mund të vendosë për shfuqizimin e miratimit të ndërtimit në rastet si më poshtë:
 - a) Me kërkesë me shkrim të mbajtësit të miratimit, kur është në pamundësi objektive të ndërtimit të linjës;
 - b) Në rastet kur personi juridik është në shkelje të rëndë të legjislacionit në fuqi në Shqipëri;
 - c) Nëse personi juridik nuk përmbush planin e punës dhe në qoftë se brenda 30 ditëve, nga njoftimi i ministrisë, nuk jep argumente bindëse për këtë dështim;
 - ç) Në rastet kur ndaj personit juridik ka nisur një procedurë falimentimi;
 - d) Në rastet kur vërtetohet se deklaratat e përdorura për aplikim kanë qenë të rreme.
- 15. Në çdo rast vendimi i ministrit i njoftohet personit juridik, i cili mund të ankimojë vendimin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III. KRITERET DHE PROCEDURAT PËR NDËRTIMIN E NJË LINJE DIREKTE, PËR LIDHJEN E NJË PRODHUESI ME NJË KONSUMATOR JASHTË VENDIT

1. Çdo person i interesuar për të ndërtuar një linje direkte, me qëllim lidhjen e një prodhuesi të energjisë elektrike me një klient jashtë territorit të Shqipërisë, duhet të paraqesë një kërkesë në ministri. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në pikat 3 dhe 4, të seksionit II të këtyre kushteve.
2. Aplikuesi duhet, gjithashtu, të paraqesë në ministri dokumentacionin e nevojshëm që të provojë miratimin e autoriteteve përkatëse të vendit fqinj, për ndërtimin e linjës direkte në territorin e saj.
3. Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, ministria do t'i japë aplikuesit një afat shtesë 60-ditor (gjashtëdhjetëditor) për sigurimin e dokumentacionit të munguar. Kërkesa do të konsiderohet e refuzuar në rast se dokumentacioni i munguar nuk është plotësuar brenda këtij afati.
4. Kur kërkesa pranohet, ministria publikon për tre ditë rresht në faqen e internetit të ministrisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 78/2014, "Për organizimin dhe funksionimin e qendrës së botimeve zyrtare", një njoftim të shkurtër me përmbajtjen e mëposhtme:

a) Një prezantim të shkurtër të subjektit kërkuar;
b) Një prezantim të shkurtër të aplikimit;
c) Adresën e ministrisë, ku çdokush mund të dërgojë vërejtjet ose komentet;
ç) Afatin brenda së cilit mund të dërgohen vërejtjet ose komentet.
5. Ministria do të sigurohet që aplikimi dhe të gjitha dokumentet mbështetëse të vihen në dispozicion të publikut për konsultim publik, përveç rasteve kur me kërkesë të aplikuesit vendoset që disa dokumente ose informacione të mbahen konfidenciale.

6. Ministri, me anë të një urdhri, do të krijojë një komision vlerësues të përbërë nga ekspertë me ekspertizën e nevojshme teknike, ekonomike dhe ligjore.

7. Komisioni do të shqyrtojë dhe do të vlerësojë kërkesën brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e tij në ministri. Data e fillimit të shqyrtimit dhe e vlerësimit të kërkesës do të jetë data kur aplikimi konsiderohet i plotësuar.

8. Komisioni do të shqyrtojë dosjen e aplikimit, duke vendosur rast pas rasti, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) Shoqëria tregon se ka aftësitë e nevojshme teknike, ekonomike dhe financiare;
- b) Funksionimi i linjës direkte nuk ndikon në rrjetin kombëtar të transmetimit dhe/ose shpërndarjes;
- c) Funksionimi i linjës mund të rritë konkurrencën në ofrimin e energjisë elektrike në treg;
- ç) Personi juridik arrin të sigurojë pëlqimin apo miratimin nga autoritetet kompetente të vendit fqinj për ndërtimin e linjës direkte në territorin e saj.

9. Miratimi i ndërtimit të një linje direkte duhet të përmbajë, të paktën, elementët e përcaktuar në paragrafin 11, të seksionit II, të kësaj kushteve.

10. Para propozimit për miratim të ministrit, komisioni vlerësues duhet të marrë pëlqimin paraprak të ERE-s.

11. Në rast të refuzimit të aplikimit, për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në këtë vendim apo në legjislacionin në fuqi, ministria njofton parashtruesin e kërkesës duke dhënë arsyet përkatëse të refuzimit. Vendimi i ministrit mund të ankimohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

IV. MIRATIMI NË KËSHILLIN E MINIS-TRAVE

Çdo miratim i ministrit për ndërtimin e linjës direkte, për të lidhur një prodhues vendas me një klient jashtë vendit, së bashku me një kopje të të gjithë dokumentacionit përkatës, dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Prodhuesit e energjisë elektrike që janë lidhur me anë të linjës direkte me klientët fundorë, janë të përjashtuar nga çdo detyrim i shërbimit publik të vendosur për të licencuarit.

2. Çdo person juridik, para fillimit të ndërtimit, në rastet kur linja direkte e miratuar kryqëzohet me linjat e administruara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe/ose Shpërndarjes, do të nënshkruajë një kontratë me këta operatorë, për rregullimin e çështjeve që lidhen me ndërtimin dhe funksionimin e linjës.

3. Këshilli i Ministrave dhe institucionet publike shqiptare, nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për shpenzimet që kryhen nga personi juridik, në rast mosrealizimi të projektit.